

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Teuta Spahiu, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit B. M., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.3718/15 të datës 15.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Mehreme Hoxha, dhe të akuzuarit, me date 28.07.2016 morri dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**B. M.**, nga i ati I., e ëma Q., e lindur D., i lindur me datën *data e lindjes...* në Prizren, ku edhe tani jeton në rrugën ... p.n., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, babai i 3 fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Se prej datës së pavërtetuar e gjer më datën 14.09.2015, në Prizren, në shtëpinë e tij familjare, përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte, jashtë njehsorit elektrik me degëzim nga kablli kryesor, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Distrikti në Prizren, i shkakton dëm material.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPK-ës, të akuzuarit ia shqipton:

**DENIM ME KUSHT**

Ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, dhe

**DËNIM ME GJOBË**

Në shumë prej 200 (dyqind) Euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg.

E dëmtuara: KEDS, Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.3718/15 të datës 15.12.2015, kundër të akuzuarit B. M., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Mehreme Hoxha, në fjalën e saj përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.3718/2015 të datës 15.12.2015, kundër të akuzuarit B. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysht të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese të merr parasysht pranimin e fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë.

I akuzuari B. M., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj veprën penale e cila më vihet në barrë, unë është fakt që e kam njehsorin në emrin tim, në të cilën njehsor është hasur nga ana e zyrtarëve të KEDS-it gjendja e cila është përshkruar në dispozitave të aktakuzës, por dua të theksoj që me rastin e ndarjes së bashkësisë familjare, dhe ate në mes vëllezërve tanë, njehsori ka qenë dhe ende është në emrin tim. Nga ky njehsor janë bërë dy dalje të shfrytëzimit të energjisë elektrike, e të cilat shpenzime nuk janë regjistruar, pasi që nuk kam pasur njehsor të veçantë. Këto dy dalje kanë qenë të parapara për dy amvisërit e vëllezërve të mi, por për arsye për mua të panjohura të njëjtit nuk e kanë vendosur njehsorin në dy dalje tjera. Në ditën kur zyrtarët e KEDS e kontrolluan njehsorin tim, ishte kjo gjendje si theksova më lartë, e cila gjendje është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës. Por, pasi që njehsori është në emrin e tim, e pranoj fajësinë për veprën penale, por i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, të ketë parasysht rrethanat lehtësuese dhe ate pranimin e fajësisë nga ana ime, që jam person familjar, baba i tre fëmijëve, kjo është hera parë që kam ra në konflikt me ligjin, si dhe faktin që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, e po ashtu gjykata të ketë parasysht edhe faktin që jam i pa punë, dhe se i vetmi burim i ekzistencës të familjes sonë është mbajtja nga ana e bijës sime e cila jeton përkohësisht në botën e jashtme. Konsideroj dhe i propozoj gjykatës që të gjitha të cekurat t'i ketë parasysht si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se prej datës së pavërtetuar e gjer më datën 14.09.2015, në Prizren, në shtëpinë e tij familjare, përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet përmes rrjetit përcues të rrymës

apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte, jashtë njehsorit elektrik me degëzim nga kabli kryesor, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Distrikti në Prizren, i shkakton dëm material.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lidhja pa autorizuar në shërbime nga neni 321 të KP-ës, paraprakisht duke vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform neni 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, baba i katër fëmijëve, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër të re penale, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.2146/15 me datë 28.07.2016**

**Procesmbajtësja**  
**Teuta Spahiu**

**Gjyqtari**  
**Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.